



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. _____

Date: 29.09.2016

580/2016
10.11.2016

Kolegji i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 29.09.2016, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Në kontestet martesore, aktgjykimi i formës së prerë, pavarësisht se çfatë ka për objekt përmbartimi, duhet të ekzekutohet në të gjitha dimensionet e tij, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Deçan, me parashtresën e datës 11.07.2016, ka theksuar se me një vendim të së njëjtës gjykatë, janë shkurozuar bashkëshortët, dhe katër fëmijët e tyre i janë besuar nënës, në ruajtje dhe edukim, mirëpo dy prej fëmijëve ndodhen tek babai, kështu që paraqitet e nevojshme që sipas këtij aktgjykimi të bëhet bashkimi i fëmijëve dhe në këtë drejtim të bëhet përmbartimi i këtij aktgjykimi. Me rastin e tentim përmbartimit të këtij aktgjykimi, fëmijët të cilët ndodhen tek babai, kanë filluar rezistencën duke u kapur për këmbëve të babait, duke qajtur, duke u zvarritur dhe duke i kërkuar ndihmë babait të tyre, që mos t'i lëshoi, deri në atë shkallë që psikologjia kërkon nga gjykata ndërprerje të veprimeve përmbartuese.

Për shkak se në nenin 320 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore parashihet që “me rastin e zbatimit të përmbartimit, gjykata sidomos kujdeset për nevojën që të mbrohen interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme”, parashtruesi i kërkesës, kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës, të jep mendimin juridik se në këto raste,

- a duhet të merren këta fëmijë me dhunë,
- a duhet të përdoret forca për marrjen e fëmijëve në raste të tilla,
- çka konsiderohet mbrojtje e interesave të fëmijës në masën më të madhe të mundshme, dhe
- a duhet të respektohet mendimi i psikologes në raste të tilla.

Gjykata Themelore Pejë - Dega në Deçan, në parashtrësën e datës 11.07.2016 ka theksuar se, me një vendim të së njëjtës gjykatë, janë shkuroreëzuar bashkëshortët, katër fëmijët e të cilëve i janë besuar nënës për ruajtje dhe edukim, por dy prej tyre ndodhen tek i ati i tyre, kështu që paraqitet e nevojshme që, sipas këtij aktgjykimi, të bëhet bashkimi i fëmijëve dhe në këtë drejtim të bëhet përmbartimi i aktgjykimit. Me rastin e tentimit të përmbartimit të këtij aktgjykimi, fëmijët që ndodhen tek i ati, kishin filluar të rezistonin, duke u kapur pas këmbëve të tij, duke qarë, duke u zvarritur dhe duke i kërkuar ndihmë atij për të mos i lënë, duke bërë këtë me aq këmbëngulje saqë e detyroi psikologun të kërkojë nga gjykata ndërprerjen e veprimeve përmbartuese. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës të japë mendimin juridik nëse në këto raste duhet:

- të merren fëmijët me dhunë,
- të përdoret forca për marrjen e tyre dhe
- çfarë konsiderohet mbrojtje e interesave të fëmijës në masën më të madhe të mundshme si dhe
- a duhet të respektohet mendimi i psikologes në raste të tilla.

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme konstaton se aktgjykimi i formës së prerë, në rastet të tilla, duhet të zbatohet domosdoshmërisht.

Në dispozitat e nenit 320 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore është parashikuar mënyra e zbatimit të përmbartimit të vendimit gjyqësor lidhur me dorëzimin dhe marrjen e fëmijës. Kështu, sipas paragrafit 1. të këtij neni, Gjykata, me rastin e zbatimit të përmbartimit, kujdeset sidomos për nevojën që të mbrohen interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme; në paragrafët 2 e 3 të këtij neni parashikohet detyrimi i debitorit që fëmijën t’ia dorëzojë prindit apo një personi tjetër të caktuar, përveç në mënyrë vullnetare, edhe me kërcënim të shqiptimit të gjobës, ndërsa në paragrafët 4 dhe 5 të këtij neni parashikohet që, nëse përmbartimi nuk ka mundur të zbatohet me shqiptimin dhe përmbartimin e vendimit të gjobës, përmbartimin mund ta bëjë vetëm gjyqtari, në bashkëpunim

me psikologun e organit të kujdestarisë, të shkollës apo të institucionit tjetër të specializuar për ndërmjetësim në marrëdhëniet familjare.

Në dispozitën e lartpërmendur ligjore nuk është parashikuar mënyra e moszbatimit të vendimeve gjyqësore për dorëzimin dhe marrjen e fëmijës, por mënyra e zbatimit të këtij vendimi, epilogun e zbatimit të të cilit nuk mund ta përcaktojë psikologu. Psikologu përkatës ka për detyrë që patjetër të gjejë mënyra psikologjike të përshtatshme për lehtësimin e zbatimit të këtij vendimi e jo ta përcaktojë në një mënyrë apo një tjetër epilogun e procedurës përmbartuese të një vendimi gjyqësor të tillë. Gjyqtarit të çështjes i mbetet të veprojë në tërësi konform dispozitave ligjore të nenit 320 të LPP.

Pavarësisht se me këto dispozita është rregulluar në mënyrë specifike çështja e përmbartimit të vendimeve gjyqësore kur kemi të bëjmë me dorëzimin e fëmijëve, (*marrja e fëmijës-ve nga njëri prind*), edhe në këto situata vlen standardi kryesor i procedurës përmbartimore se, nëse detyrimet e përcaktuara në vendimin gjyqësor nuk përmbushen vullnetarisht, ato përmbartohen edhe me zbatimin e mjeteve detyruese (dhunës). Pa mekanizmin detyrues, në të shumtën e rasteve, vendimet do të mbeteshin të paekzekutuara, për më tepër kur ligjdhënësi nuk e ka ndaluar me asnjë dispozitë përdorimin e dhunës me rastin e dorëzimit të fëmijës prindit tjetër, sipas vendimit gjyqësor.

Gjykata, me rastin e vendosjes për besimin e fëmijës, qëllim primar ka pasur interesin e tij dhe ky interes është shqyrtuar me rastin e marrjes së aktgjykimit. Përdorimi nga ligjdhënësi i shprehjes “*gjykata duhet të mbrojë interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme, me rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor*”, është bërë me qëllim që, me rastin e marrjes së fëmijës, mundësisht të shmanget marrja me dhunë e tij, (*nëse kjo është e mundur*), mirëpo kur janë shfrytëzuar të gjitha alternativat e parashikuara me ligj, por pa efekt në zbatimin e vendimit gjyqësor, duhet aplikuar edhe detyrimin për zbatimin e një vendimi të tillë. Përndryshe, vendimet gjyqësore, në marrëdhënie të tilla të armiqësuar midis bashkëshortëve të divorcuar, vështirë do të ekzekutoheshin, ngase ai prind që me vendim gjyqësor është i detyruar ta dorëzojnë fëmijën te prindi tjetër, qëllimisht me lloj-lloj veprimesh, do të ndikoi tek fëmija-ët për të krijuar skena të tilla të frikshme dhe për t'i bërë obstrukcione procesit të dorëzimit të fëmijës, përkatësisht ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Interpretimi restriktiv i shprehjes “*gjykata duhet të mbrojë interesat e fëmijës në masën më të madhe të mundshme, me rastin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor*” se, nëse fëmija nuk do vullnetarisht të shkojë te prindi tjetër, duhet ndërprerë procedura e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, do të përbënte një

mesazh jo të duhur për të gjithë debitorët që, në rastet të tilla, t'i bëjnë obstrukcione autoritetit të gjykatave në drejtim të moszbatimit të vendimet gjyqësore.

(Mendim juridik i miratuar në seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme , i mbajtur më 29.09.2016)